



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31 Mars 2021

Nr: 196

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 148, DATË 16.03.2021, TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE “PËR CAKTIMIN E VENDIT TË
NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË
DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16 Mars 2021, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij. Vendndodhja e VNV së ZAZ nr. 84 u miratua Pallati i Kulturës “Labëria”.

Prefekti i qarkut Vlorë me shkresën nr. 2902prot., datë 31.03.2021 si objekt të përshtatshëm për ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së të ZAZ nr. 84, referon Pallatin e Sportit “Flamurtari”, duke argumentuar se:

- ndodhet me distancë më të afërt me qendrat e votimit;
- ka hapësirë më të përshtatshme për të përmbushur masat anti-covid;
- ka ndriçim dhe kushte më të favorshme për VNV;



Data: 31 Mars 2021

Nr. 196

Për një ndryshim në vendimin nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”

Ky objekt, sikundër mjedisi përkatës për caktimin e VNV-së, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. ZAZ nr. 84 ka 53 QV, dhe mjedisi në këtë objekt me sipërfaqe mbi 200 m2, plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Vlorë, në KZAZ-në nr.84, objekti i caktuar për VNV, Pallati i Kulturës “Labëria”, zëvendësohet me Pallatin e Sportit “Flamurtari”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

